
KONTRATË PËR SHITJE AKSIONESH

Sot më datë **04/04/2022**, bazuar në nenin 117/1/b të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" – i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe statutin e shoqërisë "KASTRATI" SHA (NUIS L92221506G), lidhet kjo "Kontratë për shitje aksionesh" si më poshtë vijon:

Neni 1

Palët kontraktuese

1. Shoqëria "**KASTRATI GROUP**" SHA, me nr. NUIS K21711502V, nga këtu e më poshtë referuar si "**SHITËSI**", përfaqësuar nga Administratori Z. Gani Kastrati,
dhe
2. **Z. Shefqet KASTRATI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.06.1961 dhe banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal G10605213B, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nga këtu e më poshtë referuar si "**BLERËSI**".

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësi kundrejt blerësit, të **100 %** të kapitalit ose të 100 aksioneve të kapitalit, që Shitësi zotëron në shoqërinë "**KASTRATI**" SHA.

Neni 3


Çmimi i shitjes.

Çmimi total i shitjes së aksioneve është vlera nominale e tyre prej **ALL 3,500,000** (tre milion e pesëqind mijë lekë).

Neni 4

Mënyra e pagesës

Palët deklarojnë që çmimi i shitjes së aksioneve i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, do të likuidohet prej Blerësit me nënshkrimin e kësaj kontrate.



Neni 5

Detyrimet e shitësit

Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes dhe mënyrën e pagesës, të parashikuar në Nenin 3 dhe 4 të kësaj kontrate, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së aksioneve, që ai kishte në shoqërinë "**KASTRATI**" **SHA**, aksione të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.

Shitësi garanton se aksionet, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi aksionet objekt të kësaj kontrate, aksione të cilat i kalojnë blerësit.

Neni 6

Detyrimet e Blerësit

Blerësi do të paguajë çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Neni 7

Gjuha e Kontratës

Kjo kontratë përgatitet në 2 ekzemplarë në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

Neni 8

Hyrja në fuqi


Kjo kontratë hartohet në 2 kopje të njëjta dhe origjinale, dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

KASTRATI GROUP SHA

Përfaqësuar nga:


Z. Gani Kastrati


[emër, mbiemër, firmë]



BLERËSI

Z. Shefqet Kastrati



[emër, mbiemër, firmë]